

VENDIM
Nr. 68/2024

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA RADHËT E AVOKATËVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET
E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Bledar Bajri
2. Albens Tabaku

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024